



Komuna e Klinës

Kryetari i Komunës

01Nr. 112-6507 /2026

Klinë, datë 04/03 /2026

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040, publikuar në Gazetën Zyrtare, nr.28 me dt. 04.06.2008, në nenit 91 paragrafi 1 i Statutit të Komunës së Klinës të dt.07.04.2010, si dhe duke marrë parasysh dispozitat e Rregullores së QRK-së, Nr.22/2020 për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar, Kryetari i Komunës së Klinës, mori;

V E N D I M

Për formimin e komisionit Komunal për Riintegrim (KKR)

1. **FORMOHËT**, komisioni komunal për riintegrimin e personave të riatdhesuar në komunën e Klinës, sipas strukturës dhe përbërjes të përcaktuar si në dispozitat e nenit 44 të Rregullores së QRK-së, nr.22/2020 për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar. Përbërja e komisionit është siç, vijon;
 - 1.1 Agron Bacaj, Drejtor i DSHMS, kryesues;
 - 1.2 Gazmend Dautaj, përfaqësues i ZKKK-së, anëtarë;
 - 1.3 Hana Thaqi, përfaqësuese e QPS-së, anëtarë;
 - 1.4 Debatik Duraku, përfaqësues i ZP-së, anëtarë;
 - 1.5 Binak Sylaj, Drejtor i Administratës, anëtarë;
 - 1.6 Qemajl Sejdiu, Drejtor i Arsimit, anëtarë;
 - 1.7 Antonije Selmani, përfaqësuese e DUMM, anëtarë;
 - 1.8 Mirsad Dakaj, zyrtarë për Integritet Evropian, anëtarë;
 - 1.9 Egzon Sejdiu, përfaqësues i financave, anëtarë;
 - 1.10 Shendrit Gashi, përfaqësues i shërbimeve publike, anëtarë;
 - 1.11 Arianit Nrecaj, përfaqësues i kadastrit dhe gjeodezisë, anëtarë.
2. KKR vlerëson nevojat e personave të riatdhesuar lidhur me qasjen në regjistrat e gjendjes civile, pajisjen me dokumentet civile, arsimimin dhe regjistrimin në shkollë, trajtimin psiko-social në rast nevojë dhe ndihmën sociale, banimin, rregullimin e dokumenteve kadastrale si dhe kërkesave tjera të parapara me rregulloren e QRK-së, nr.22/2020.
3. Komisioni komunal si nga pika 1 e këtij vendimi është organ vendimmarrës në nivelin lokal, e cili vendimet i merr me shumicë votash dhe aktivitetin e vet e ushtron në bazë të Rregullores së (QRK-së) nr.22/2020 për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.
4. Ky vendim është i plotfuqishëm dhe hynë në fuqi menjëherë, me të cilin shfuqizohet vendimi, nr.01-561-2155/2022 i datës 18.01.2022.

Te njoftohen:

- Anëtarët e komisionit;
- ZKKK;
- MPB Prishtinë;
- Arkivi.

Kryetari,
Zenun Elezaj

